

EMPLOY -YOUR- SELF!

Shkurt 2020

No.2

Mundësitë e Punësimit për Të Rinjtë në Ekonominë Shoqërore

Në këtë numër

Po bashkëndajmë me ju detajet nga Vizita Studimore, Citimet e Tiziana Ciampolini nga Caritas Torino dhe Informacione rreth aktivitetit të radhës së projektit

Aktiviteti i parë i *Employ yourself* realizua!

Vendimi dhe motivimi janë shumë të rëndësishëm për çdo fillim, kryesisht të gjitha ndërmarrjet shoqërore fillimisht fillojnë me vështirësi. Vizita studimore ishte aktiviteti i parë i projektit "Employ Yourself" me misionin kryesor për të motivuar të rinjtë që të fillojnë iniciativat e tyre. Përmes kësaj nisme, të rinjtë kishin mundësitë të njiheshin me shembujt më të mirë të nismave shoqërore në Torino, Italy, dhe ekzaminimin e mënyrave sesi ata janë përballur me probleme dhe suksese. Të rinjtë pjesëmarrës ishin nga Bosnja dhe Hercegovina, Shqipëria, Bullgaria, Greqia, Italia, Kosova, Mali i Zi dhe Serbia. Gjatë kësaj vizite tre-ditore, nga data 18 deri në datën 20 të muajit shkurt, ata panë shumë praktika të ndryshme. Banka Intesa Sanpaolo ishte një nga shembujt që arrin misionin e saj përmes mbështetjes së ekonomisë së vendit, duke siguruar financime dhe shërbime për bizneset dhe familjet. Duke vepruar kështu, banka nxit dhe forcon rolin e saj shoqëror, marrëdhëniet e saj me komunitetin dhe rajonet ku operon, falë rrënjëve të forta historike dhe kulturore. Mbrotja, përmirësimi dhe akses i publikut janë faktorët themelorë në filozofinë e përgjegjësisë shoqërore që Intesa Sanpaolo e shikon si elementin thelbësor të rritjes dhe zhvillimit. Skuadra e S-nodi dhe Fa Bene ishin disa shembujt të tjerë që lidheshin me Caritas Torino-n dhe Caritas-in Italian, të cilat mbështesin iniciativat kundër pabarazisë dhe varfërisë, menaxhojnë procesin e risive shoqërore përmes veprimeve të përqendruara në punën bashkëpunuese. Projekti Humus ishte një shembull me misionin për të lidhur njerëzit përmes ndarjes së punës në bujqësi në zonat rurale. Opera Barolo ndërmjet organizatës dhe shërbimeve të tyre ndajnë shembujt në strehimin, mikëpritjen dhe shoqërimin përmes përfshirjes shoqërore dhe drejtësisë riparuese.

Përmes bashkëpunimit me Universitetin e Torinos, Departamenti i Menaxhimit drejton një punishte, për të cilën bashkëndau njohuri me pjesëmarrësit për mjetet inovative të menaxhimit të mallrave të zakonshëm. Rrjeti Coldiretti dhe Campagna Amica prezantuan projektet e tyre të bujqësisë shoqërore dhe "ushqimit civil". Restoranti Ex Mattatoio ishte një projekt i misionit shoqëror reciprok, dhe vizita e fundit ishte në ndërmarrjen shoqërore bujqësore "La cascina del mulino" që është një shembull që ndan një seri shtigjesh në bujqësinë shoqërore të cilat konsiderohen si risi dhe për të cilat ka marrë disa çmime kombëtare.



**S-NODI – lidhje dhe mundësi
10,000 njerëz mund të ndihmohen me forcën
e vullnetarizmit.**

**Mesazhi i thjeshtë i kësaj vizite studimore është të fillosh,
Tiziana Ciampolini, Caritas Torino, Opera Barolo**

Aktiviteti i Radhës >>>>>

**Sikurse trazimi i COVID-19 ka
prekur të gjitha aktivitetet tona, ai
i radhës do të jetë:**

**Akt. 1.3 Trajnimi në veprimin
e prespektivave të ekonomisë
sociale kundër varfërisë (TSE)**



Vendi: Ferizaj (Kosovë)

Datë: 12-16 tetor 2020

**Trajnimi mbi ekonominë sociale
është një orientim hyrës rreth
mundësive për të rinjtë e
dhënë nga modelet alternative
ekonomike dhe ndërmarrjet
sociale. Trajnerët (ekspertët e
organizatave anëtare nga grupi
drejtues) do të prezantojnë
mundësitë e dhëna nga modelet
alternmative ekonomike dhe
ndërmarrjet sociale.**

Link-e të dobishm >>>>>

<https://www.intesasanpaolo.com/>
http://www.socialplatform.org/wp-content/uploads/2017/03/cs13_fa_bene.pdf

<https://www.torinosocialimpact.it/en/activities/4981/>

https://www.facebook.com/pg/ExMattatoioChieri/posts/?ref=page_internal

<http://www.cascinadelmulino.it/home.htm>

<https://www.agricopecetto.com/>



Co-funded by the
Erasmus+ Programme
of the European Union

Projekti „Employ Yourself“ është i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian përmes programit të Erasmus+ dhe i udhëhequr nga Caritas Bosnje dhe Hercegovina, në bashkëpunim me Caritas-es kombëtare nga 7 shtete: Shqipëria, Bullgaria, Greqia, Italia, Kosova, Mali i Zi, Serbia.